



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2021

Lënda: Dërgim informacioni, lidhur me situatën e luftës kundër trafikimit të personave për periudhën Janar – Shtator 2021

Në zbatim të pikës 5 të Urdhrit Nr. 6, datë 26.01.2017 të Kryeministrit “Për krijimin e komitetit rajonal, të luftës kundër trafikimit të personave, në çdo qark”, për vlerësimin e situatës së luftës kundër trafikimit të personave, në zbatim të planit të veprimit të Komitetit Rajonal, ju informojmë mbi shërbimet e ofruara nga Bashkia e Shkodrës, ndërhyrjet, aktivitetet dhe masat e marra lidhur me problemet e luftës kundër trafikimit të personave, për periudhën Janar – Shtator 2021, si më poshtë:

Bashkia e Shkodrës, në zbatim të Planit Vendor të Veprimit për fëmijët në situatë rruge, gjatë periudhës Janar - Shtator 2021 skuadrat e terrenit, të përbëra nga punonjës të qendrave komunitare “Për Familjen” dhe policë bashkiakë, kanë qenë funksionale në zonat kryesore ku janë identifikuar fëmijë në situatë rruge, si në qytet ashtu edhe në zonën kufitare të Muriqanit.

Përgjatë sezonit veror, muajve qershor-shtator puna e terrenit ka pasur një vëmendje të shtuar. I gjithë stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik ka qenë funksionale me orare të zgjatura, në zonën kufitare të Muriqanit, Zonën Ura e Bunës- Ura e Bahcallekut, qytet, për të realizuar identifikimin dhe menaxhimin e fëmijëve në situatë rruge.

Numri i fëmijëve dhe numri i familjeve të identifikuar në situatë rruge dhe mbështetur është 60, ndërsa numri total i rasteve të menaxhuara për këtë periudhë është 65.

Disa nga shërbimet bazë të ofruara për këto fëmijë dhe familjet përkatëse janë:

- Rregjistrim për here të parë në RSH;
- Rregjistrim, transferim në Gjendjen Civile;
- Mbështetje me vizita mjekësore, medikamente, karta shëndetësore, vaksinim;
- Rregjistrimi i fëmijëve në shkollë/kopshte dhe ofrimi i transportit;
- Pajisje me çanta dhe mjete didaktike;

- Në bashkëpunim me Nisma për Ndryshim Shoqëror, Unicef dhe Terres des hommes për vitin shkollor 2021-2022 janë mbështetur me orë edukative shtesë fëmijët në situatë rruge që frekuentojnë shkollën Salo Halili, Martin Camaj;
- Ofrimi i një vakti të ngrohtë pranë mensës së ngritur në QKMF, të Bashkisë Shkodër me mbështetjen e Food Bank;
- Pranë QKMF ofrohen dhe shërbimet të higjenës dhe lavandari për familjet dhe fëmijët në situatë rruge;
- Në bashkëpunim me Terre des Hommes janë ofruar për vitin shkollor 2020-2021 klasa mbështetëse për fëmijët e QKPF nr.5 ku bëjnë pjesë dhe fëmijët e kampit rom tek Zalli i Kirit, të cilat do të vazhdojnë të ofrohen edhe për vitin shkollor 2021-2022.
- Në fillim të vitit shkollor 2020-2021 janë mbështetur me çanta dhe materiale didaktike 256 fëmijë, ndërsa për vitin shkollor 2021-2022 janë mbështetur 160 fëmijë;
- Janë mbështetur me paketa mbështetëse (ushqim, veshmbathje, paketa higjeno-sanitare etj familjet e fëmijëve rom / egjiptian dhe familjet me vështirësi social-ekonomike në kushtet e pandemisë COVID-19;
- Ofrimi i mundësive të punësimit dhe vetëpunësimit;
- Mbështetje për akses në skemën e ndihmës ekonomike;
- Pajisje me ID kartë;
- Mbështetje ligjore për ndjekjen e procedurave administrative ose gjyqësore.

Shërbimet që ofrohen për fëmijët në situatë rruge dhe për komunitetin rom dhe egjiptian, shërbejnë për integrimin dhe fuqizimin e këtij komuniteti, me qëllim parandalimin e fenomeneve sociale si trafikimi, abuzimi, etj., duke qenë se janë potencial i mundshëm për shkak të kushteve të vështira në të cilat jetojnë.

Në lidhje me rastet e evidentuara dhe personat e identifikuar si VT/VMT gjatë kësaj periudhe janë identifikuar dhe menaxhuar dy raste: viktima të mundshme të trafikimit, fëmijë në situatë rruge, si dhe vazhdon menaxhimi i rasteve të identifikuar gjatë vitit 2021. Rastet vazhdojnë në familje nën mbikëqyrjen e Qendrave Komunitare “Për Familjen” dhe organizatës “Të ndryshëm, të barabartë” të cilët ofrojnë shërbime të specializuara për këto raste.

Në lidhje me këto raste janë marrë masat si më poshtë:

Rasti i të miturit 1. për cilin është mbledhur GTN-ja dhe është realizuar denoncimi në polici për shfrytëzim për personin që institucioni ku është i sistemuar i mituri dyshon që e shfrytëzon.

Rasti i të miturës 2. fëmijë i identifikuar në situatë rruge, e parregjistruar në gjendjen civile. Është marrë masë emergjente e mbrojtjes dhe është hapur proces gjyqësor për konfirmimin e masës emergjente të mbrojtjes dhe caktimin e kujdestarisë. Vendimi i gjykatës lidhur me rastin është në kundërshtim me interesin më të lartë të fëmijës, pasi fëmija është kthyer me vendim gjyqësor në familje.

Nga ana jonë vendimi i gjykatës është apeluar dhe rastin është referuar për mbështetje pranë organizatës “Të ndryshëm & të Barabartë”.

Vazhdon menaxhimi i rasteve të identifikuar gjatë vitit 2020.

Rasti i të miturit 3. lindur në Peshkopi dhe banues në Shkodër, fëmijë të cilët jetojnë në vendqëndrimin e komunitetit romë .

- Është trajtuar nga Qendra Komunitare Multifunkionale “Për familjen” e Bashkisë Shkodër, pasi ka qenë me masë mbrojtëse “Mbikëqyrje e specializuar në familje” dhe ka përfituar paketë të plotë të shërbimeve në familje duke përfshirë dhe trajtim psikologjik, për shkak se është gjetur dy herë i pashoqëruar dhe i dhunuar në Durrës dhe Tiranë.
- Me datë 04.02.2020 i mituri është sistemuar pranë Shtëpisë së Fëmijës Shkodër 6-15 vjeç, si rast emergjent, pasi ishte larguar nga familja në mënyrë të përsëritur duke vënë në rrezik sigurinë fizike dhe për shkak të lidhjeve me persona më të rritur që dyshohet se e shfrytëzojnë për shpërndarje të lëndëve narkotike. I mituri është larguar disa here nga ky institucioni e në orare të ndryshme duke e bërë të pamundur qëndrimin aty.
- Në këto kushte, kemi kërkuar shërbime më të specializuara dhe i mituri është sistemuar pranë Qendrës së Emergjencës të organizatës “Plan&Go” në Tiranë me datë 07.02.2020, por përsëri fëmija është larguar nga ky institucion.
- Aktualisht i mituri është kthyer në familjen e tij biologjike në Shkodër dhe në zbatim procedurave standarte rasti është referuar në drejtorinë e Shërbimit Social Rajonal dhe SHSSH për një strehim afatgjatë në një qendër pritëse për VT ose VMT që vepron në nivel kombëtar, por akoma nuk kemi një përgjigje nga ana e tyre.

Rasti i të miturës 4. lindur dhe banuese në Shkodër.

- E mitura është trajtuar me programet e mbrojtjes shoqërore nga qendra komunitare “Për Familjen” nr. 2 e Bashkisë Shkodër. Gjatë menaxhimit të rastit është vërejtur që e mitura shoqërohet në mënyrë të vazhdueshme me persona të panjohur nga ana e familjes së saj, më të rritur se mosha e saj dhe për këtë nga ana e punonjësës sociale të qendrës është vlerësuar që e mitura rrezikon të shfrytëzohet nga ana e tyre.
- Me datë 07.02.2020 nga përfaqësues të NJMF të Bashkisë Shkodër dhe përfaqësues të policisë e mitura është intervistuar dhe është vlerësuar viktimë e mundshme e trafikimit.

- Nga kontaktet e realizuara me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe me strehëzat pritëse për viktimat/ viktimat e mundshme të trafikimit, me datë 10.02.2020 pranë Bashkisë Shkodër është paraqitur stafi i strehëzës “Vatra” (qendër reabilituese në ndihmë të viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit) me qëllim shoqërimin, sistemimin e së miturës pranë kësaj strukture, por e mitura dhe nëna e saj nuk e pranuan këtë mundësi dhe aktualisht ajo po qëndron në familje.
- Më pas, më 12.02.2020 i jemi drejtuar me shkresë zyrtare Policisë së Rrethit Shkodër për të ndjekur/ monitoruar dhe trajtuar këtë rast, si dhe është kërkuar identifikimi i personave që e shfrytëzojnë të miturën.
- Ndërkohë, i jemi drejtuar organizatës “Të ndryshëm & të barabartë” në Tiranë, (organizatë e specializuar për të ofruar shërbime për viktimat e trafikimit), me qëllim ofrimin e shërbimit pranë familjes, të cilët janë përgjegjgur pozitivisht dhe janë paraqitur në Shkodër për të intervistuar të miturën, por edhe ky shërbim është refuzuar nga e mitura dhe nëna e saj.
- Gjatë periudhës COVID 19 familja është mbështetur nga ana e Bashkisë Shkodër me pako ushqimore dhe higjieno sanitare dhe rasti është monitoruar në distancë me anë të telefonit.
- Me datë 03.06.2020 pasi jemi kontaktuar nga nëna e fëmijës, e cila me anë të një mesazhi kishte marrë lajmërim nga e bija e mitur që do largohej për 3-4 muaj nga shtëpia.
- Nga kontakti me nënën është orientuar menjëhere që të lajmërojë Policinë.
- Në kushtet kur kjo shtetase nuk kishte bërë akoma njoftimet pranë organeve përkatëse, pavarësisht orientimeve tona, kemi lajmëruar në numrin telefonik 129. Më pas i jemi drejtuar policisë dhe me e-mail për ta vënë në dijeni për largimin e vajzës.
- Me datë 04.06.2020 meqënëse vajza akoma nuk ishte gjetur, kemi qenë në polici për të kallëzuar dhe njoftuar tek seksioni i të miturve, Policia e Rrethit Shkodër për largimin e fëmijës dhe marrjen e masave për heqjen e përgjegjësisë prindërore për shtetasen dhe për trajtimin e rastit në vazhdim.
- Me datë 05.06.2020 është realizuar takimi i Grupit Teknik Ndërsektorial u vendos që të merret masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, të përgatitet dokumentacioni i nevojshëm dhe të ndiqen procedurat në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër për konfirmimin e masës të mbrojtjes.

- Me datë 19.06.2020 nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është konfirmuar masa e mbrojtjes për vendosjen e së miturës pranë një strukture të specializuar që ofron shërbime integruese për viktimat e mundshme të trafikimit.
- Për zbatimin e këtij vendimi është urdhëruar Komisariati i Policisë Shkodër dhe Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor Shkodër.
- Me datë 22.06.2020 i është dërguar shkresë Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër duke iu drejtuar me kërkesën për ekzekutimin e shkurtimit të vendimit Nr.76, datë 19.06.2020 dhe shkurtim vendimi Nr.77, datë 19.06.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër.

Rasti i të miturës 5. fëmijë i institucionalizuar pranë shtëpisë familje 16-18 vjeç Shkodër, lindur në Vlorë dhe me vendqëndrim pranë institucionit shtëpi familje 16 -18 vjeç Shkodër.

- Me datë 22.05.2020 jemi njoftuar nga drejtorja e institucionit Shtëpi Familje 16-18 vjeç Qershor 2020 Shkodër për intervistimin e së miturës pasi, ajo largohet në mënyrë të vazhdueshme nga institucioni, duke shkelur rregullat e karantinimit dhe që dyshohet nga ana e tyre që mund të jetë viktimë e mundshme të trafikimit.
- Menjëherë pas vënies në dijeni me datë 22.05.2020, e mitura, është intervistuar nga NJMF, bashkia Shkodër dhe Specialistë të antitrafikut (Policia Vendore Shkodër); ku nga intervista fillestare duke u nisur nga reagimet mohuese të së miturës që të trajtohet si VMT, si dhe pretendimet e së miturës gjatë intervistimit që stafi përgjegjës po sajn problematika për ta larguar atë nga institucioni, është ndërprerë nga ana jonë intervista formale duke i lënë kohe dhe detyrë psikologut të institucionit të punojë me të miturën gjatë kësaj periudhe me qëllim që të vazhdohet më tej për ndjekjen e procedurave sipas ligjit.
- Me datë 29.05.2020 është mbledhur grupi teknik ndërsektorial me qëllim marrjen e masave dhe hartimin e planit individual të mbrojtjes me qëllim ndjekjen procedurave sipas ligjit duke marrë për bazë interesin më të lartë të së miturës.
- Sipas detyrave të përcaktuara nga GTN është realizuar intervista formale sipas formës standart të veprimtimit për VT dhe VMT, e mitura është vlerësuar nga specialistët VMT.
- Pasi është kontaktuar me qendrën pritëse "Vatra" në Vlorë, është bërë i mundur dhe sistemimi i të miturës pranë kësaj qendre të specializuar për trajtimin e rastit.

Rasti i të miturës 6. Lindur në Shkodër dhe banuese në Njësinë Administrative Velipojë.

- Rasti është referuar nga Policia e Rrethit Shkodër, dhe nga intervista e realizuar më të miturën dhe nënën e saj, rezulton që edhe e mitura edhe nëna e saj janë viktima të trafikimit.
- Nga informacioni i referuar nga ana e Policisë. për personat që i kanë shfrytëzuar shtetasat në fjalë janë marrë masat e duhura nga ana e institucionet përgjegjëse dhe aktualisht janë të dënuar.
- Pas intervistimit, i është ofruar mundësia e sistemimit pranë një strukture të specializuar për VMT/VT rezidenciale, por kjo mundësi është refuzuar nga ana e nënës së fëmijës.
- Më pas është ofruar mundësia për të marrë shërbimet e specializuar për VMT/VT pranë familjes, mundësi e cila është vlerësuar nga e mitura dhe nëna e saj.
- Për këtë më datë 01.07.2020 është caktuar një takim më përfaqësues të organizatës partnere Të ndryshëm, të barabartë, Tiranë (organizatë e specializuar për trajtimin e Viktimave të trafikimit), stafi i Njmf dhe përfitueset e shërbimeve me qëllim ofrimin e mbështetjes pranë familjes.

Rasti i të miturës 6. është intervistuar në prani të specialistes së narkotikëve dhe trafikeve, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër dhe punonjësës për mbrojtjen e fëmijëve, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Bashkia Shkodër.

- Nga intervista e realizuar rezulton që e mitura është vlerësuar si VMT.
- Pas intervistimit, i është ofruar mundësia e sistemimit pranë një strukture të specializuar për VMT/VT rezidenciale.
- Është njoftuar qendra pritëse organizata "Të ndryshëm, të barabartë" Tiranë, në të cilën dhe është akomoduar vajza e mitur dhe merr aktualisht të gjitha shërbimet përkatëse.

Rasti i të miturës 7. është intervistuar në prani të specialistes së narkotikëve dhe trafikeve, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër dhe punonjësës për mbrojtjen e fëmijëve, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Bashkia Shkodër.

- Nga intervista e realizuar rezulton që e mitura është vlerësuar si VMT.
- Pas intervistimit, i është ofruar mundësia e sistemimit pranë një strukture të specializuar për VMT/VT rezidenciale.
- Është njoftuar qendra pritëse organizata "Të ndryshëm, të barabartë", Tiranë, e cila e ka futur në programet e saj të mbështetjes dhe i ofron në familje të gjitha shërbimet përkatëse.

Rasti i të miturës 8. është intervistuar në prani të specialistes së narkotikëve dhe trafiqeve, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër dhe punonjësës për mbrojtjen e fëmijëve, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Bashkia Shkodër.

- Nga intervista e realizuar rezulton që e mitura është vlerësuar si VMT.
- Pas intervistimit, i është ofruar mundësia e sistemimit pranë një strukture të specializuar për VMT/VT rezidenciale.
- Është njoftuar qendra pritëse organizata "Të ndryshëm, të barabartë", Tiranë, e cila e ka futur në programet e saj të mbështetjes dhe i ofron në familje të gjitha shërbimet përkatëse.

Rasti i 9. lindur dhe banuese në Shkodër.

Me datë 23/05/2020 rasti është identifikuar në situatë rruge nga punonjës të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik të Bashkisë Shkodër.

- Menjëherë pas identifikimit rasti është strehuar pranë konviktit të shkollës Arben Broci, ku janë realizuar edhe vlerësimet fillestare të nevojave specifike të rastit.
- Me datë 28.05.2020 zonja është intervistuar nga punonjës të Bashkisë Shkodër dhe nga intervista fillestare si dhe nga reagimet pohuese të zonjës, rasti mund të trajtohet si VMT.
- Me datë 28.05.2020 është vënë në dijeni menjëherë autoriteti përgjegjës përmes postës elektronike dhe institucionet e tjera kompetente.
- Me datë 29.05.2020 është realizuar një takim me qëllim marrjen e masave dhe ndjekjen e procedurave sipas ligjit me përfaqësuesit e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër.
- Me datë 01.06.2020 është realizuar intervista nga specialistja e DRSHSSH, Shkodër dhe specialistja e DVP Shkodër , ku sipas indikatorëve rasti është përcaktuar si VMT.
- Me datë 05.06.2020 është sistemuar pranë shoqata "Kouniteti Papa Xhovani XXIII", ku i janë ofruar edhe të gjitha shërbimet e nevojshme si: strehim, ushqim, mbështetje mjekësore, psikologjike etj.Në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.254, datë 10.04,2020 "Për protokollin e funksionimit të qendrave rezidenciale Publike dhe jopublike, që ofrojnë shërbim e strehim (strehëza) për viktimat e

dhunës në familje dhe trafikimit, në situatën e pandemisë së COVID-19” është akomoduar në dhomën e posaçme për karantinimin dy javor.

- Pas një nate qëndrimi ka shprehur kërkesën për t’u larguar nga Qendra duke refuzuar marrjen e shërbimeve të ofruara dhe është larguar nga Qendra me datë 06.06.2020.
- Rasti është referuar nga Bashkia Shkodër tek organizata Të ndryshëm, të Barabartë, në Tiranë, të cilët me datë 12.06.2020 kanë realizuar takimin me të duke i ofruar mundësinë e akomodimit në strehëzën e organizatës së tyre, mundësi e cila është refuzuar në mënyrë kategorike.
- Në vazhdim i është ofruar rastit mundësia e mbështetjes në Shkodër duke i siguruar një ambjent me qera, pajisjen me ID, mbështetjen me pako ushqimore, veshmbathje, punësim, kurs formimi profesional, asistencë me ndihmë ligjore dhe këshillim psiko-social.

Sa i përket familjeve në vështirësi social-ekonomike, që janë trajtuar me ndihmë ekonomike, me fillimin e vitit 2018 Skema e Ndhmës Ekonomike ka ndryshuar në koncept dhe dokumentacion.

Procedura e marrjes së vendimit është e përcaktuar me VKM Nr. 597, datë 04.09.2019 " Përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". Vendimmarrja për caktimin e familjeve në nevojë, përfituese të Ndhmës Ekonomike, i ka kaluar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Më poshtë gjeni pasqyrën me të dhëna konkrete të numrit të familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike gjatë periudhës Janar- Gusht 2021.

Nr. familjeve në skemën e ndihmës ekonomike								
	Janar 2021	Shkurt 2021	Mars 2021	Prill 2021	Maj 2021	Qershor 2021	Korrik 2021	Gusht 2021
Bashkia Shkodër (Total)	1810	1855	1898	1913	1938	1931	1834	1826
Njësia Shkodër (Qytet)	278	286	289	284	285	288	273	272

Me hyrjen në fuqi të sistemit elektronik kombëtar për ndihmën ekonomike, në kompetencë të Bashkisë mbetet përzgjedhja e përfituesve të ndihmës ekonomike me fonde të kushtëzuar deri në 6%, kjo përzgjedhje bëhet nga familjet e refuzuara për mungesë pikësh nga sistemi elektronik kombëtarë. Përqindje shumë e vogël fondi për të mbuluar nevojat dhe pritshmëritë e të gjithë atyre familjeve që nga sistemi elektronik kombëtar rezultojnë që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme.

Kjo skemë përmbledhet në tabelën e mëposhtme:

Nr. i familjeve përfituese në skemën e nd. Ekonomike me fond deri në 6%								
	Janar 2021	Shkurt 2021	Mars 2021	Prill 2021	Maj 2021	Qershor 2021	Korrik 2021	Gusht 2021
Nr. Fam	204	209	209	209	211	207	207	-
Fond deri në 6%	563580	1109640	1134568	1147600	1164016	1141120	549884	-

Numri i personave përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar për periudhën Janar-gusht 2021:

Nr. i përfituesve në skemën e paaftësisë								
	Janar 2021	Shkurt 2021	Mars 2021	Prill 2021	Maj 2021	Qershor 2021	Korrik 2021	Gusht 2021
Paaftësi	4023	3995	4010	3971	3961	3945	3928	3930
Inv. Pune	3284	3320	3295	3289	3285	3270	3276	3274

Në kuadër të ndërgjegjësimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, Bashkia Shkoder ka realizuar një sërë aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me dhunën me bazë gjinore gjatë periudhës Janar-Shtator 2021. Janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjëse në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas kalendarit të paracaktuar, në bashkëpunim me organizatat. Janë organizuar 15 aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.

Në kuadër të 30 korrikut-Ditës Botërore Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, nën moton "Mos Dhuro Para, Dhuro Kujdes" janë realizuar aktivitete që kanë për qëllim të parandalojnë efektisht shfrytëzimin e fëmijëve për qëllime të përfitimeve ekonomike. T'i dhurosh para fëmijëve në situatë rruge, nxit dhe kushtëzon qëndrimin e tyre në rrugë. Prandaj ndihma ekonomike apo edhe vullnetare duhet të shkojë drejt institucioneve që ofrojnë shërbime për fëmijët, shkollat, institucionet publike, fetare, organizatat e shoqërisë civile, etj. Fuqizimi i fëmijëve me anë të kujdesit nëpër qendra dhe institucione komunitare ndikon drejtpërdrejt edhe në konsolidimin dhe integrimin efektiv të familjeve të tyre në shoqëri. Prandaj është e nevojshme më shumë se kurrë që të mos dhurojmë para, por të dhurojmë kujdes. Gjithashtu, në këtë kuadër është realizuar edhe një video ndërgjegjësuese për këtë qëllim.

Gjatë muajit shtator është hartuar programi për organizimin e aktiviteteve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese për muajin Antitrafikim, konkretisht 21 aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuese për trafikimin e personave të shpërndara në Qendrat Komunitare "Për Familjen" dhe shkollat e Bashkisë Shkodër, si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.

Këto aktivitete synojnë rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin me qëllim parandalimin e fenomenit të trafikimit të personave.

Aktivitetet janë organizuar në bashkëpunim të ngushtë me OSHC-të të tilla si: Gruaja tek Gruaja, Hapat e lehtë, Të ndryshëm, të barabartë, Nisma/ Arsis, Terre Des Hommes dhe janë të pasqyruara në faqen e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

<https://www.facebook.com/Drejtoria-e-Sh%C3%ABrbimeve-Sociale-Strehimit-dhe-Sh%C3%ABndetit-Publik-Shkod%C3%ABr-207655856280284/>

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar disa trajnime të cilat kanë pasur në fokus çështjet e antitrafikimit me stafin e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik dhe specialistët e Qendrave Komunitare "Për Familjen".

Bashkia Shkodër tashmë ka të ngritur dhe funksionale edhe një qendër ditore që ofron shërbime me orare të zgjatura dhe në fundjavë, për fëmijët e rasteve të dhunës në familje, VMT apo VT. Aktualisht në këtë qendër marrim shërbim 7 fëmijë.

Bashkia e Shkodrës do të vazhdojë punën për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin të komunitetit për trafikimin e personave.

Problematikat dhe vështirësitë janë të shumta:

- Vazhdon mosbashkëpunimi i komunitetit rom për ndryshimin e vendbanimit në mënyrë që të kenë akses në shërbimet publike si strehimi, ndihma ekonomike etj.
- Mungesa e bashkëpunimit nga ana e vetë komunitetit rom dhe egjiptian për t'u angazhuar në integrimin e tyre social e ekonomik duke u përfshirë në kurse profesionale, punësim, edukim etj.
- Bashkëpunimi me policinë duhet të jetë më eficient që në momentin identifikimit si dhe në trajtimin e rasteve të referuara në zbatim të nenit 124/b si dhe të procedurave për kërkesat për urdhër të menjëheshëm të mbrojtjes si dhe për procedurat për marrjen e masave të menjëhershme të mbrojtjes të fëmijëve.
- Fenomeni i shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve dhe konkretisht ai i shfrytëzimit të fëmijëve për lypje, që është më prezent në Bashkinë Shkodër, shpesh nuk trajtohet me seriozitet dhe në mënyrën e përcaktuar në ligj, nga të gjitha institucionet e ngarkuara për mbrojtjen e fëmijëve. Edhe në rastet e të miturve të identifikuar si viktime të mundshme të trafikimit duhet të insistojmë për bashkëpunimin e policisë.
- Megjithë fushatat ndërgjegjësuere të ndërmarra, konstatojmë mungesë të ndërgjegjësimit të qytetarëve përsa i përket fenomenit të lypjes dhe pasojat që ka shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve.

Bashkia e Shkodrës ka vazhduar punën për shtrirjen dhe konsolidimin e rrjetit të shërbimit komunitar në territor, nëpërmjet krijimit të qendrave të reja komunitare “Për Familjen”. Aktualisht janë 12 Qendra Komunitare “Për Familjen” të konsoliduara dhe që ofrojnë shërbime në komunitet.

Gjatë kësaj periudhe, shërbimet e ofruara për fëmijët dhe familjet janë si më poshtë:

Shërbime parashoqërore

- Informim
- Orientim
- Këshillim
- Shërbim në familje
- Ndërhyrje e hershme

Shërbime Komunitare

- Mbrojtja e fëmijëve
- Shërbime për fëmijën, familjen fuqizimin ekonomik, programe prindërimi
- Fuqizim komuniteti
- Shërbime arsimore
- Riintegrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore
- Shërbim për higjenën personale, kujdesin shëndetësor dhe edukimin.

Në vazhdim, synohet konsolidimi i shërbimeve komunitare në territorin e bashkisë së Shkodrës, për informim, orientim, këshillim, fuqizim, integrim të fëmijëve dhe familjeve në vështirësi socio-ekonomike, në bashkëpunim të ngushtë ndër institucional.

KRYETAR

Voltana Ademi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 16557 Prot
Shkodër, më 28.09.2021.



SHOQATA E INVALIDËVE
PARA & TETRAPLEGJIKË
SHQIPTARË

Nr. 17 Prot
Shkodër, më 28.09.2021

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot në Bashkinë Shkodër, me datë ___/___/___, ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

Bashkia Shkodër, me adresë: rruga 13 Dhjetori, nr 1, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër **Znj. Voltana Ademi**, këtej e tutje e cilësuar si **Bashkia**

dhe

Shoqatës së Invalidëve Para & Tetraplegjikë Shqiptarë, e regjistruar ne gjykate me vendimin nr. 294, datë 24. 06. 2002, me nr. NIPTL61318451S, me adresë: Rruga e Durrësit, Ish Uzina Tirana, Shqipëri, përfaqësuar nga kryetari **Z. Ndrek Smajli**.

NENI 1
Objekti

Objekti i kësaj Marrëveshje është bashkëpunimi dhe vendosja e ndërveprimit të përbashkët midis Shoqatës së Invalidëve Para & Tetraplegjikë dhe Bashkisë Shkodër, duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e ndërsjellta në zbatimin e ndërhyrjeve të synuara, me qëllim mbështetjen dhe integrimin e individëve me aftësi ndryshe, që të kenë akses në lëvizje, në një edukim, shërbim shëndetësor e rehabilitues, dhe gjithëpërfshirës, me synimin që të jenë të mbrojtur dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre.

NENI 2
Baza ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në :

Ligji nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” i ndryshuar;

Ligji nr. 7850 datë 10.07.1994 ‘Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë’ të ndryshuar;

Adresa: Nr. 12 Dhjetori, nr 1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al



Ligji nr. 9062, datë 08.05.2003 'Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë' i ndryshuar;

Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse" të ndryshuar;

Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" ;

Ligji nr.10 221 datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi";

Ligji nr. 9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" të ndryshuar ;

V.K.M nr. 658 datë 17.10.2005 "Për standartet e shërbimeve shoqërore".

NENI 3

Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim rregullimin dhe forcimin e bashkëpunimit institucional ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Shoqatës së Invalidëve Para & Tetraplegjik që personat me aftësi ndryshe para dhe tetraplegjik të përfitojnë nga realizimi i projekteve të përbashkëta me synim përmirësimin e mirëqënies së jetës dhe gjendjes së tyre sociale, fizike, psikologjike dhe emocionale.

NENI 4

Angazhimet e Palëve

Për realizimin e marrëveshjes Shoqata e Invalidëve Para & Tetraplegjik, merr përsipër:

- Të zhvillojë aktivitete gjithëpërfshirëse dhe rehabilituese në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër për përmirësimin e kushteve sociale dhe fizike të personave me AN, në veçanti atyre më në nevojë.
- Të mirë administrojë dhe mirëmbajë ambjentet e vëna në përdorim nga Bashkia e Shkodrës me synim integrimin dhe përfshirjen e personave me AN.
- Të bashkëpunojë me rrjetin e qendrave komunitare "Për Familjen" për njohjen dhe vlerësimin e situatës së personave me para e tetraplegji.
- Të bashkëpunojë me Bashkinë Shkodër në hartimin dhe zbatimin e projekteve që kanë në fokus mbështetjen e PAN.
- Të mbështesë Bashkinë Shkodër dhe të kontribuojë në procese vendore që synojnë integrimin e PAN-ve në bashkëpunim me aktorët vendorë që punojnë për njohjen dhe respektimin e të drejtave tyre në territorin e Bashkisë së Shkodrës.
- Angazhohet të paraqesë pranë Bashkisë Shkodër informacion të shkruar në mënyrë periodike, (çdo 6 muaj) mbi ecurinë e aktiviteteve, objekt i kësaj marrëveshjeje, arritjet dhe problematikat e hasura dhe të dhëna statistikore mbi numrin e përfituesve të shërbim ve të ofruara.



Adresa: Rr. 25 Tetradhok, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al



Për realizimin e marrëveshjes Bashkia Shkodër merr përsipër:

- Të bashkërendojë e koordinojë me insitucionet e saj të varësisë dhe me Shoqatën e Invalidëve Para&Tetraplegjikë planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshjeje me qëllim zhvillimin e aktiviteteve gjithëpërfshirëse dhe rehabilituese të personave me AN.
- Të sigurojë ambjente dhe lehtësira infrastrukturore si kontribut nga ana e saj për realizimin e aktiviteteve me dhe për PAN, edhe në rrjetin e qendrave komunitare “Për Familjen”.
- Të koordinojë sistemin e menaxhimit të rasteve të identifikuara në bashkëpunim me Shoqatën e Invalidëve Para & Tetraplegjik.
- Të bëjë pjesë dhe të ftojë Shoqatën e Invalidëve Para&Tetraplegjik në takimet periodike të OJF aktive në territor.
- Të bashkërendojë me Shoqatën e Invalidëve Para & Tetraplegjik mundësitë e aksesit dhe të parkimit për PAN, gjatë planifikimeve dhe projekteve infrastrukturore.
- Të informojë dhe lehtësojë procedurat për mbështetjen siç parashikohet nga ligji në lidhje me shërbimet/përfitimet për PAN dhe familjeve tyre.

NENI 5

Përfundimi i marrëveshjes

Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje në rastet kur:

- a. mbaron afati i kohëzgjatjes i përcaktuar në marrëveshje;
- b. shkelen dispozitat e ligjit dhe të marrëveshjes;
- c. palët nuk i përmbahen qëllimit dhe objektit të marrëveshjes;
- d. për forcë madhore

Secila nga palët duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të marrëdhënieve të Marrëveshjes, duke dhënë sqarime të hollësishme dhe të qëndrueshme mbi këtë ndërprerje.

Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

NENI 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me mirëkuptim, me bisedime ndërmjet tyre, deri në gjetjen e një zgjidhje të përbashkët.

Adresa: Rr. 16 Dhjetori, Nr. 1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al



Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të saj nga të dyja palët dhe është e vlefshme nga data 01/09/2020 deri në 01/09/2021.

Dispozita të fundit

- a. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik pranë Bashkisë Shkodër dhe Shoqata e Invalidëve Para&Tetraplegjik me strukturat e tyre përbërëse për zbatimin e detyrave të parashikuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.
- b. Çdo rregullim ose ndryshim në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi bëhet vetëm në formë të shkruar dhe nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve.
- c. Marrëveshja e Bashkëpunimit mund të përfundojë me njoftimin me shkrim të secilës palë, një muaj pas këtij njoftimi.
- d. Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) kopje, nga 2 (dy) kopje për secilën palë, të cilët pasi bien dakord e nënshkruajnë atë rregullisht.

ENI 8

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të saj nga të dyja palët dhe është e vlefshme nga data 01/09/2020 deri në 01/09/2021.

**PËR
BASHKINË SHKODËR**

KRYETAR

Voltana Ademi



**PËR
SHOQATËN E INVALIDËVE
PARA&TETRAPLEGJIKË
KRYETAR**

Ndrek Smajli

